




INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

JANAR- DHJETOR 2019

Në këtë dokument janë pasqyruar aktivitetet, punët dhe angazhimet e Kryetarit të Komunës dhe drejtorive komunale, të cilat janë realizuar gjatë periudhës (Janar-Dhjetor) 2019 po ashtu janë prezentuar me fotografi të ndryshme edhe ecuritë e realizimit të projekteve kapitale në komunën e Rahovecit.

KRYETARI I KOMUNËS

Parathënie

Të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit,

Qeverisja e mirë nënkupton shërbim ndaj qytetarëve. Komuna e Rahovecit është e përkushtuar që këtë shërbim ta kryej në mënyrën më të mirë të mundshme.

Kryetari Smajl Latifi është zotuar se do t'i çojë deri në fund premtimet e tij për ta ndryshuar jetën e qytetarëve të komunës së Rahovecit.

“Unë dhe bashkëpunëtorët e mi kemi vetëm një detyrë, dhe ajo është që t'iu shërbejmë qytetarëve me dinjitet dhe sa më mirë” – është motoja e qeverisjes së tij.

Vizioni

Vizioni ynë i përbashkët për Rahovecin është: “Përmirësimi i mirëqenies së të gjithë qytetarëve, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve publike, që janë të qasshme në nivel lokal, krijimi i kushteve më të mira për investime në ekonomi, kthimi i hapësirave nga menaxhimi i APK (Agjencioni Pyjor i Kosovës) në menaxhim nga komuna, bujqësi e zhvilluar, infrastrukturë të rregulluar, përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies sociale, edukim, arsimim dhe shërbime të cilësisë së lartë për qytetarët tanë.

Prioritetet tona kryesore për Rahovecin vazhdojnë të jenë

- Administratë efikase, e përgjegjshme dhe me shërbime moderne
- Qeverisje energjike, vepruese dhe vendimmarrje pa vonesë
- Organizim më i mirë i punës dhe efikasitet i plotë i administratës komunale
- Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit
- Realizim i planit të të hyrave komunale
- Rritje të përkrahjes për bujqësinë dhe për fermerët
- Këshillime me fermerë dhe hartim të projekteve për aplikime të suksesshme
- Përmirësimi i gjendjes së ujërave të zeza dhe trajtimi i problemeve me ujërat atmosferikë
- Furnizim me ujë të pijshëm
- Ndërtim i rrugëve të reja dhe mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese
- Mirëmbajtje e hapësirave publike, krijimi i hapësirave të reja për parkingje, mirëmbajtja e rrugëve dhe ndërtimi shesheve dhe rrugicave
- Investime në ndriçimin publik
- Funksionalizim më i madh, rritje e cilësisë dhe kohëzgjatje e shërbimeve nga ana e QKMF-së
- Vizita sistematike shëndetësore nëpër të gjitha shkollat
- Nxitje të investimeve dhe projekteve në turizëm

- Trotuare dhe shtigje të ecjes për këmbësorë e biciklistë
- Projekte për kullimin e tokave bujqësore
- Rritje e cilësisë dhe investime në arsim
- Bursa për studentë
- Investime në nyjat sanitare dhe meremetim të shkollave
- Ndërtimi i shkollave të reja
- Eficienca e energjisë në objektet shkollore dhe në objektet e tjera publike
- Hartimi i PZHK-së dhe Hartës Zonale
- Trajtimi i shtretërve të lumenjve dhe përrenjve
- Mirëmbajtja e hapësirave ekzistuese të gjelbëruara dhe krijimi i hapësirave të reja të gjelbëruara
- Rritja e rolit dhe shtimi i aktiviteteve të inspektoratit
- Terrene të reja sportive dhe përkrahje sportit
- Aktivitete të planifikuara me të rinjtë
- Përkrahje nismave për më shumë aktivitete kulturore
- Investime në trashëgimi kulturore, si dhe përkrahje aktiviteteve e përkujdesje ndaj figurave kombëtare, objekteve dhe të pozicioneve që kanë të bëjnë me ngjarjet e rëndësishme historike
- Përballje serioze dhe me efikasitet të lartë me çfarëdo situatë që ka të bëjë me emergjencat
- Të krijohen kushte të përshtatshme për investime të drejtpërdrejta për të mirën e qytetarëve përmes krijimit të vendeve të përhershme të punës si dhe zhvillimit ekonomik
- Rregulli dhe disiplina në institucione
- Mbarëvajtja e punëve dhe rritja e efikasitetit të punonjësve
- Fuqizimi i marrëdhënieve mes qeverisjes lokale dhe qytetarëve është prioritet për qeverisje të mirë dhe demokratike
- Përfshirja e qytetarëve në politikbërje i mundëson qeverisjes lokale të krijojë burime të reja të ideve, informatave dhe resursve në marrjen e vendimeve
- Respektim i parimeve të procesit të vendimmarrjes: Transparenca, Llogaridhënia dhe Gjithëpërfshirja
- Shërbim për nevojat, kërkesat e të gjithë qytetarëve pa dallim, ofrim i shërbimeve publike në kohë, përgjigje pa vonesa ndaj shkresave dhe adresimeve të ndryshme që i vijnë komunës
- Zbatim i objektivave të premtuara dhe përdorim më i mirë i mundshëm i kapacitetit njerëzor, burimeve dhe kohës në dispozicion për të siguruar rezultatet më të mira të mundshme për qytetarët
- Kontakt i rregullt dhe komunikim i hapur me qytetarët e të gjitha shtresave
- Ide dhe projekte të reja në të gjithë sektorët komunal
- Mirëmbajtja e mjedisit dhe hapësirave publike
- Përgatitje me kohë e planeve vepruese për funksionim më të mirë dhe për arritje të komunës si rezultat i qeverisjes


Dokumenti që po e prezantojmë sot përfshin detaje nga këto të arritura dhe suksese të qeverisjes sonë, aktivitete të rëndësishme të paraqitura me fotografi. Kemi kënaqësinë të paraqesim para jush dokumentin lidhur me aktivitetet, punët, angazhimet dhe arritjet e komunës së Rahovecit për periudhën, janar – dhjetor 2019.

Aktivitete të rëndësishme gjatë periudhës janar- qershor 2019



Komuna e Rahovecit është përballur me reshje të vazhdueshme të borës, ku kemi intervenuar me të gjitha kapacitetet tona në gjithë komunën.

Nxjerrja e urdhëresës që është parandaluese dhe ndëshkuese lidhur me rastet e keqtrajtimit, vrasjes dhe garave të kundërligjshme të kafshëve.



№. i protokollit: 01/2019
Mu datë: 2.01.2019
Rahovec, 2019

Duke u bazuar në artilin 8 dhe mesin 17 të artitit (1) dhe artitit (2) të Ligjit për Përkrahjen ndaj Kufshëve Nr. 023-10 (Gazeta zyrtare e Institutit të Përkrahjes të Vetëqeveritjes së Komunitetit, 5/2006), mesazh 13 dhe mesazh 18 të Ligjit për Vetëqeveritjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 033-060 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 20/2008) dhe mesazh 24 dhe 92 të Statutit të Komunitetit të Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunitetit Shpreh kështu:

URDHËRËSË PËR NDALIMIN E VRASJES, KEQTRAJTIMIT DHE ORGANIZIMIT E GARAVE TË KUNDËRLIGJSHME TË KAFSHËVE

1. Me kështu urdhërohet NDALOHET vrasja, keqtrajtimi, ekspozimi i kafshëve në lumenj, opoziti kështuqë nëse qyteti të modifikuar në detyrë të kafshëve në të cilin lumenjtë apo detyrat e tilla du të jepen të tregu, importimi dhe shpita e kafshëve agresive në kundërligjet me dispozitat e Ligjit, transportimi i kafshëve për qytetin, transporti i kafshëve në kundërligjet me dispozitat ligjore, organizimi i garave në të cilat trondit fashja apo dispozitat e kafshëve me ç'kafshë mund të përdoret shpesh, shpesh apo ngjashmëri apo bled organizimi i tyre në kundërligjet me dispozitat ligjore dhe përdorimi i substancave për kafshë që mund të jenë të cilat në, për të përdorimi me dispozitat ligjore.
2. Urdhërohet të përdorë efektive joshitja në ditë tërësisht e Komunitetit të Rahovecit.
3. Ndërkohë që të cilat ligjet në kundërligjet me dispozitat e kështu urdhërohet të të ndalohet me gjetë prej 100 deri 5.000 Euro sipas mesazh 17 të Ligjit për Përkrahjen ndaj Kufshëve.
4. Për zbatimin e kështu urdhërohet të të përkrahjet Detyra për Inspeksion të Komunitetit të Rahovecit.
5. Urdhërohet kështu në fashë organizimi për shpallim nga Kryetari i Komunitetit.

Me urdhërohet të aplikohen:

- Detyra për Inspeksion,
- Zyrë për monitorimin me publikim,
- Qyteti për shpallim me qytetin, dhe
- Arkivi.



Në kuadër të Flakës së Janarit, kujtuam dhe nderuam jetën dhe veprën heroike të dëshmorëve me aktivitete të ndryshme përkujtimore, kulturore dhe artistike



Rinia e Rahovecit është pasuria jonë më e madhe. Si Komunë, shprehim gatishmërinë që të përkrahim projekte të të rinjëve tanë me të gjitha kapacitetet deri në realizim. Njëkohësisht, ne vazhdimisht inkurajojmë të rinjtë tanë që të angazhohen dhe japin kontributin e tyre për Rahovecin!



Shënimi njëmbëdhjetë vjetorit të Pavarësisë së Kosovës nga komuna e Rahovecit, ka filluar me aktivitetin tradicional të pritjes së qytetarëve, për të vazhduar me homazhe për ata që dhanë jetën për liri e pavarësi, në një seancë solemne të Kuvendit Komunal të Rahovecit, është shpallur 'Qytetar Nderi' i komunës së Rahovecit poeti i mirënjohur, Xhevahir Spahiu!

Krahasuar me komunat e mëdha të Kosovës, komuna jonë është renditur e dyta për nga transparenca, sipas "Transparometrit komunal"- KDI. Përkundër se ka përparim të dukshëm, ku padyshim tregon për një arritje të madhe e të kënaqshme, ne si Komunë do të vazhdojmë të punojmë shumë që në matjet e radhës të jemi të parët!



Palestra e Sporteve, "Mizahir Isma", në qytetin e Rahovecit, si një projekt i tejzgjatur me vite të tëra, për më shumë se një dekadë, është jetësuar (finalizuar) më datë: 27 shkurt 2019

Foto nga momenti i vënies së gurthemelit të shkollës fillore në Retijë dhe çasteve të këndshme me banorët e kësaj ane



Me vendim të Kryetarit, të gjithë inspektorët janë autorizuar të shqiptojnë gjoba mandatore, njëkohësisht është marrë vendim për punë shtesë si dhe kujdestari pas orarit të rregullt edhe gjatë ditëve të vikendit, për inspektimin e ndërtimeve, ambientit, lokaleve



Përruam sallën sportive të Shkollës së Mesme "Ukshin Hoti" në Krushë të Madhe. Është projekti i dytë madhor pas gurthemelit të shkollës në Reti që e përruam me rastin e 7 marsit, Ditës së Mësuesit.



Kemi nënshkruar kontratën (marrëveshjen e bashkëpunimit me Caritas Kosova, për implementimin e projektit: "Shërbime për realizimin e vitalizimit të infrastrukturës për funksionalizimin e shtretërve shtëpiak". Vlera e përgjithshme e projektit është: 194.398.00€, për periudhën 12 mujore, ndërsa me anë të këtij projekti janë punësuar 53 punëtorë, të cilët do të ofrojnë shërbime shëndetësore si dhe në arsim (pedagogji dhe psikologji) për qytetarët e Komunës së Rahovecit.



Me Ministrin e Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, kemi nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për financimin e projekteve infrastrukturore në Komunën e Rahovecit. Konkretisht, me anë të kësaj marrëveshje, do të financohen dy projekte shumë të rëndësishme – asfaltimi i rrugës Fortesë – Hamoc – Rahovec me vlerë 700,000 euro si dhe asfaltimi i rrugës Xërxë – Sapniq – Ratkoc me vlerë prej 800,000 €.



Banka Botërore do financojë projektin e rehabilitimit dhe modernizimit të rrjetit të ujitjes në sistemin e Radoniqit. Vlera e projektit do të jetë 13.5 milion€, ky është një lajm i rëndësishëm për komunën tonë pasi që ne do të jemi përfituesit më të mëdhenj pjesa dërrmuese e projektit e kap territorin e komunës së Rahovecit! Me përfundimin e kësaj faze të rehabilitimit dhe modernizimit të rrjetit ekzistues do të hapet rruga për fazën e dytë, ku përfshihet edhe zgjerimi i rrjetit deri në 8000 ha, duke përfshirë pjesë kodrinore dhe vreshtare.



Mikja e madhe e Kosovës, Japonia, po vazhdon me kontribute të mëdha për shtetin tonë!

Këtë herë, Komuna e Rahovecit ka pranuar mbi 75,000 euro donacion në Zyrën Japoneze, shumë kjo e destinuar për blerjen e një kamioni modern për zjarrfikje dhe shpëtim!



Kryetari Latifi ka mbajtur takim me kryetarët e zgjedhur të fshatrave dhe lagjeve të Rahovecit.

Ai uroi të gjithë për zgjedhjen e tyre në post si dhe diskutuan për çështjet me prioritet për secilin vendbanim.



Komuna e Rahovecit ka vendos për partneritet strategjik me komunën e Studeniçanit. Është vendosur poashtu që së shpejti të nënshkruajmë marrëveshje bashkëpunimi në veçanti për aplikimin e përbashkët në thirrjen e Bashkimit Evropian për bashkëpunim ndërkuftar. Qëllimi i bashkërendimit të aktiviteteve dhe resurseve ka të bëjë me përmirësimin e ambientit dhe promovimit e zhvillimit të trashëgimisë kulturore



Kemi përruar ndriçimin publik në Varrezat e Dëshmorëve në Hoçë të Vogël! Një investim si ky është më e pakta që mund të bëjmë, në nderim të atyre që dhanë jetën për Kosovë.



Shoqata "Jetimët e Ballkanit", bashkë me Komunën e Rahovecit do të ndërtojme 7 shtëpi për 7 familje me nevojë në Rahovec.



Cikli i diskutimeve me qytetarë ka përfunduar në të gjitha vendbanimet e Rahovecit, Kryetari ka paraparë takimet me qytetarë si formën më të mirë për të dëgjuar shqetësimet dhe nevojat e qytetarëve, në mënyrë që të jemi afër tyre, të përmirësojmë jetën e qytetarëve dhe të planifikojmë më mirë investimet.



Gjatë kësaj periudhe janë ndarë gjithsej 95 bursa për studentë të komunës së Rahovecit që studiojnë në universitetet publike në vend. Kështu, në krahasim me vitin e kaluar, ne kemi rritur dukshëm numrin e studentëve përfitues të bursave komunale, nga 63 sa ishin vitin e kaluar, për këtë vit kanë përfituar 95 studentë.



Ka përfunduar aksioni për heqjen e mbeturinave në Çifllak, përgjatë Drinit të Bardhë. Mjedisi i pastër dhe i mbrojtur vazhdon të mbetet njëri nga prioritetet më të rëndësishme të qeverisjes komunale, andaj aksionet e tilla deri në eliminimin e të gjitha mbeturinave nuk do të ndalen!



Kryetari Latifi ka nënshkruar një marrëveshje të bashkëfinancimit me ministrin e MMPH-së, z. Fatmir Matoshi. Sipas kësaj marrëveshjeje, MMPH me Komunën e Rahovecit do të financojnë projektin e trajtimit të shtretërve të lumenjve dhe përrockave, për bashkëfinancimin e projektit: “Pastrimi i profileve kritike-emergjente të lumenjve për mirëmbajtje të kapacitetit bartës të ujë-rrjedhave”, i cili financohet nga MMPH-ja në vlerë prej 60.000 €. Ky projekt ka qëllim parandalimin e vërshimeve në lumin që lidh Krushën e Madhe dhe Celinën, ku shkaktohen vërshime.

Komuna e Rahovecit vazhdon me punë...



Kryetari i Komunës së Rahovecit ka nënshkruar memorandum të rëndësishëm bashkëpunimi me ministrin e MZHR-së, z. Rasim Demiri. Ky bashkëpunim ka rëndësi të madhe për turizmin e Rahovecit, sepse përfshin asfaltimin e rrugës prej epopesë së UÇK-së deri te Maja e Shkodranit. Përveç tjerash, në projekt parashihet edhe një shteg për çiklizëm i gjatë 3300 m, ndërsa i gjerë 1.5m. MZHR do të financojë me 95,000€.



Si Komunë kemi plan konkret dhe jemi maksimalisht të përkushtuar që ta mbrojmë dhe ruajmë mjedisin e pastër si dhe të rrisim hapësirat e gjelbëruara në Rahovec.



Kemi nënshkruar tri memorandume mirëkuptimi me ministrin e Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, z. Kujtim Gashi sipas të cilëve, kjo ministri do të financojë: Ndërtimin e stadiumit të futbollit të kategorisë së dytë, në qytet, sipas standardeve të FIFA-s; Ndërtimin e palestrës sportive në Krushë të Madhe; Ndërtimin e stadiumit të futbollit të kategorisë së dytë, me standardet e Superligës së Kosovës, në Ratkoc. Projektet kanë vlerë 2 milionë e 150,000€.



Si komunë, jemi të përkushtuar që ta rregullojmë infrastrukturën dhe kemi filluar me asfaltimin e një pjese të qytetit e do vazhdojmë edhe me pjesë të tjera.



Ndriçimi publik është shumë i rëndësishëm për qytetarët. Ne si komunë jemi të përkushtuar që të vazhdojmë të investojmë në këtë drejtim. Së fundmi është vendosur ndriçimi publik në fshatin Ratkoc, një projekt ky i mirëpritur dhe kërkuar nga banorët e kësaj ane!

AKTIVITETE NUK KANË TË NDALUR



VAZHDOJMË.....

Na ndiqni në ueb faqe:

<https://kk.rks-gov.net/rahovec>

Qeveria e Kosovës mori vendim për të ndarë 1 milionë euro për dëmet e shkaktuara në bujqësinë e Rahovecit nga breshëri dhe vërshimet!

Ky është një vendim i madh dhe i drejtë, pas kërkesave të shumta nga Komuna e Rahovecit dhe zotimeve të qeverisë, Urojmë fermerët e Rahovecit të cilët do të vazhdojmë t'i përkrahim me të gjitha kapacitetet e do të jemi pranë tyre për çdo nevojë e kërkesë që kanë e që është në të mirën e zhvillimit të bujqësisë në Rahovec!



Zakonisht, të enjteve Kryetari i Komunës mban takime të rregullta me qytetarët e Komunës së Rahovecit.

Në takime pret afaristë e fermerë, të rinj e të reja, njerëz të vyeshëm e punëtorë që vijnë për bashkëbisedim, ndonjë shqetësim, kërkesë, ide etj.

Kjo praktikë është mirëpritur nga qytetarët, kurse ne si qeverisje na ndihmon që të kuptojmë më mirë kërkesat dhe nevojat e tyre.

Bujqësia është segment kyç i ekonomisë së Rahovecit dhe jemi krenar që prodhimet e fermerëve tanë janë të kualitetit të lartë dhe të standardeve evropiane!



Kemi nënshkruar memorandum mirëkuptimi me kompaninë e derivateve Shell Kosova. Sipas këtij memorandum, të gjithë fermerët e komunës së Rahovecit që janë në regjistrat e Drejtorisë për Bujqësi, do të përfitojnë zbritje prej 0,05€ për litër në çdo furnizim në Shell. Ky memorandum mirëkuptimi dhe gatishmëria e komunës për të tilla bashkëpunime është edhe një dëshmi e qartë se jemi afër fermerëve dhe do të angazhohemi maksimalisht për t'ua lehtësuar atyre punën drejt prodhimeve sa më cilësore.



Ka përfunduar asfaltimi i rrugës transite në Rahovec. Ky projekt është nisur tash e 8 vjet por nuk ka mundur të finalizohet për shkak të problemeve pronësore, të cilat i kemi zgjidhur me kujdes në këtë mandat. Ndërtimi i kësaj rruge mbështetet nga MI.

Ka përfunduar asfaltimi i rrugës Krushë e Madhe në drejtim të Randobravës!

Ky projekt është mbështetur nga Ministria e Infrastrukturës pas kërkesës nga Komuna e Rahovecit.



Kemi nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me Ministrinë e Infrastrukturës për ndërtimin e rrugës me 4 korsi në relacionin Rahovec - Xërxë! Ky projekt ka vlerë të parashikuar 3.4 milionë euro dhe është i një rëndësie të veçantë sa i përket infrastrukturës rrugore, sepse krijon kushte më të mira të qarkullimit dhe lëvizjes së qytetarëve. Rruga Rahovec - Xërxë do të jetë autorrugë e tipit të hapur dhe e standardeve më të larta dhe njëkohësisht, projekti më i madh infrastrukturor në komunën e Rahovecit

Për të tetëmbëdhjetin vit me radhë është mbajtur festivali folklorik 'Anadrinia Jehon', i cili tashmë ka krijuar profilin e vet dhe është futur në agjendën e festave të komunës së Rahovecit.





Kemi pranuar çmimin për performancën më të mirë komunale për vitin 2018 (top 4)!

Ky çmim është dëshmi për seriozitetin, përkushtimin dhe efikasitetin e ekzekutivit komunal në Rahovec. Kemi edhe shumë punë para vetes dhe jemi në rrugë të drejtë për t'u bërë shembull i mirë i qeverisjes lokale në nivel vendi!

Më datë 16 maj 2019 është mbajtur akademi politike-shkencore kushtuar veprimtarit të çështjes kombëtare, Ukshin Hoti, të vetëdijshëm për peshën morale e institucionale të përgjegjësisë që kemi, vendosëm të organizojmë këtë tryezë shkencore.



Janë nënshkruar kontratat për dhënien e subvencioneve për Kulturë dhe Rini në Komunën e Rahovecit. Prioritet i Komunës është që të vazhdojë t'i qëndrojë afër rinisë, kulturës, sportit, artizanateve, subjekteve që trajtojnë kategori të caktuara sociale në Rahovec. Kjo u dëshmuar edhe me subvencionet: 41,300 € janë ndarë në vitin 2017, kurse 62,000 € në vitin 2018, dhe në vitin 2019 është ndarë shuma rekorde 101,100 € për Kulturë, Rini dhe Sport. Poashtu, në Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale janë ndarë gjithsej: 13,800€ për vitin 2019

Infrastruktura publike mbetet një ndër prioritet e qeverisjes sonë

Në Dejnë përruam ndriçimin publik.

Dejni dhe çdo vendbanim tjetër i komunës do të gëzojnë edhe shumë projekte të tjera në dobi të mirëqenies së njerëzve tanë.



Më datë 28 maj 2019 shënuam ditën e Shtëpisë së Kulturës "Mensur Zyberaj". Organizimi i sa më shumë festave e ngjarjeve kulturore në këtë vatër të kulturës, jo vetëm që përbën thelbin e ekzistimit të qendrës së kulturës, por është mënyra më e mirë për të nderuar kujtimin për të rënë.



Shumë shpejtë presim të hapet Reparti i Hemodializës në QKMF, gjë që është një sfidë dhe kjo po tejkalohet, reparti do të hapet në pjesën e dytë të vitit 2019 dhe pacientët me dializë do të kenë mundësi që shërbimet t'i marrin në repartin e Hemodializës në QKMF- Rahovec.



Me një program të pasur artistik, në të cilin protagonistë ishin pikërisht fëmijët, u shënuar 1 qershori - Dita e Fëmijëve në Rahovec. Le të punojmë edhe më shumë bashkë, si shoqëri, që çdo ditë ta bëjmë ditë të shënuar për fëmijët tanë!



Për herë të parë, me qëllim të lehtësimit të procedurave për fermerët tanë, ka filluar aplikimi i fermerëve për subvencione në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, përveç Rahovecit. Kështu, fermerët e këtyre fshatrave dhe fshatrave përreth e kanë më të lehtë aplikimin dhe janë në asistencë nga stafi i Drejtorisë për Bujqësi për të qenë në rregull me të gjitha dokumentet! Ne do të vazhdojmë të jemi pranë fermerëve të Komunës së Rahovecit me planet dhe projektet që i kemi për bujqësinë, si një nga prioritetet kryesore të qeverisjes sonë



Një shembull i mirë i bashkëpunimit në mes të komunës dhe qytetarëve në fshatin Dejnë, aty ku pasi është bërë ndriçimi publik në rrugën kryesore, banorët me vetiniciativë kanë filluar vendosjen e ndriçimit publik në rrugët e lagjeve.
Banorët morën pëlqimin e Komunës për vendosjen e dritave, ndërsa mirëmbajtjen dhe shpenzimet e rrymës i merr përsipër Komuna e Rahovecit.

Jemi krenarë me investimet e mërgatës në Kosovë dhe njëkohësisht, si komunë do të vazhdojmë të punojmë shumë që të krijojmë një mjedis sa më tërheqës ekonomik për investime nga mërgata jonë dhe investime të huaja



Është nënshkruar edhe një marrëveshje të rëndësishme për financimin e dy projekteve me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal: Zgjerimi i ndriçimit publik në komunën e Rahovecit, 40.000€ si dhe Trajtimi i kanalizimeve fekale (gropa septike), 20.000€.
Mjetet financiare i kemi fituar nga Granti i Performancës për komunat e Kosovës, në të cilën Rahoveci është radhitur e katërta, si komunë me performancë të mirë. Vlera e financimit të këtyre projekteve është 60,000€ për të cilat e falënderojmë MAPL-në.



Shënimi i 14 Qershorit, Ditës së Çlirimit të Rahovecit, me aktivitete të ndryshme kulturore e artistike.





Për nder të Ditës së Çlirimit të Rahovecit, është shpalosur murali i dy heronjve të kombit, Tonit e Micit. Ky mural me portretet e tyre, i vendosur në ballin e shtëpisë së Haxhi Shabandulës, i përgatitur me kujdes nga artisti rahovecas Florent Pista, krahas bukurisë që shihet, shpreh edhe madhëstsinë, ashtu siç është edhe vepra e tyre.



Me rastin e ditëlindjes së 76-të të atdhetarit të madh, prof. Ukshin Hotit, në mjediset e shtëpisë muze të Ukshin Hotit në Krushë të Madhe është mbajtur një tubim sensibilizues për fatin e këtij politikani, profesori, personaliteti të njohur shkencor, njëherësh, atdhetar e veprimtar i shquar i çështjes tonë kombëtare.

Rahoveci ka pasur vërshime të shumta, të cilat padyshim se janë shqetësuese për qytetarët dhe për ne si qeverisje!

Me qëllim që të gjejmë një zgjidhje permanente ndaj këtij problemi që po përsëritet tash e shumë herë, është mbajtur takim me arkitektë dhe inxhinierë nga Komuna e Rahovecit. Është vendosur që bashkë të punojmë inensivisht dhe të dalim me një projekt ideor i cili njëherë e mirë do i jepte fund këtij problemi të madh e të kamotshëm me të cilin po ballafaqohemi si komunë!



Përgjatë tri ditëve, për herë të parë në Komunën e Rahovecit është mbajtur ushtrimi fushor i FSK-së, "Ujku 02/2019". Njësitë e ushtrisë sonë (BRSH-së, BAT II) bashkë me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Njësinë e Zjarrfikësve, Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, Kryqin e Kuq në Rahovec, Stacionin e Policisë së Kosovës në Rahovec, SHL Kosovën dhe vullnetarët, në këto ditë kanë testuar shkathtësitë, aftësitë dhe efikasitetin e reagimit në rastet emergjente, me shumë sukses!

Kemi filluar realizimin e një prej planeve tona kryesore për Rahovecin, ndërtimin e fushave sportive në disa fshatra dhe qytet. Punimet i kemi filluar në fshatin Dejnë. së shpejti do të fillojmë ndërtimin e fushave sportive edhe në Rahovec, Kramovik e Optrushë.



Ecuria e projekteve kapitale në komunën e Rahovecit, aktivitete të rëndësishme



Projekti “Ndërtimi i infrastrukturës për festivalin dhe tregun e rrushit” janë kryer të gjitha pozicionet dhe është pranuar teknikisht ky projekt. Kanë filluar procedurat për fazën e dytë, ku theksi do të bie te ndërtimi i shtëpizave (tezgave) prej druri që shërbejnë për ekspozim dhe shitje të produkteve bujqësore si dhe disa pozicioneve që janë të parapara me projekt.



Projekti për uljen e nivelit të përroit në fshatin Celinë, projekti ka vazhduar edhe përkundër faktit se gjatë punimeve janë shfaqur disa probleme, si është rasti me nënkalimin te hekurudha, pengesat e gypëve të sistemit të ujitjes, por që tani janë tejkaluar dhe projekti është në fazën përfundimtare. Tani punimet janë duke vazhduar në segmentin e tretë nën magjistralen Prizen-Gjakovë, dhe me përfundimin e këtij segmenti do të konsiderohet i tërë projekti i përfunduar.



Projekti i kullimit të tokave bujqësore në Xërxë, Banorët kanë parashtruar kërkesë që kanali në segmentin përgjatë rrugës të ndërtohet i mbyllur. Ne e kemi aprovuar këtë kërkesë pasi kemi konsideruar se përmban arsyeshmëri. Projekti është duke vazhduar sipas planit dinamik të paraqitur nga operatori ekonomik.

Me përmirësimin e kushteve klimatike ka rifilluar ndërtimi i serrave nga Operatori Ekonomik që ka kontratë me komunën e Rahovecit. Në qershor ky projekt ka përfunduar dhe janë ndërtuar gjithsej 117 serra.

Përfundimi i këtij projekti hap rrugën për shpallje të thirrjes së re për fermerë.



Në tremujorin e parë të vitit, në bashkëpunim me organizatën IADK me të cilën kemi të nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi kemi implementuar disa projekte si:
Projekti për trajnim të të rinjve në sektorin e bujqësisë për grup moshat 18-29 vjeç,
Aplikimi dhe shpërndarja e granteve për të Riatdhesuarit,
Grantet në sektorin e Bimëve Mjekësore Aromatike – BMA.

Duke e parë që fermerët e komunës sonë gjatë viteve të kaluara kanë hasur në vështirësi në kompletim të dokumenteve dhe hartim të projekteve, ne kemi marr përsipër që të ju dalim në ndihmë fermerëve duke asistuar dhe këshilluar fermerët për mënyrën e aplikimit, kompletim të dokumenteve dhe hartimin e projekteve. Për këtë arsye, ne si komunë për herë të parë kemi ndërmarrë që projektet të kryhen në kuadër të drejtorisë dhe janë pa pagesë. Gjatë kësaj kohe kemi zhvilluar procedurat për shpallje të tenderit si dhe është lidhur kontrata për “Konsulencë dhe hartim i projekteve për fermerë” që do të aplikojnë për grante në ministri.




Pas rreshjeve të fundit të shiut, drejtori i BPZHR-së Berat Duraku ka dalur në teren për të parë më afër gjendjen e disa zonave që rrezikohen nga vërshimet e mundshme. Ai ka takuar edhe disa nga fermerët të cilët janë dëmtuar si pasojë e këtyre reshjeve. Disa nga zonat që janë në pjesët e rrafshëta dhe si pasojë e kullimit të ujit nga disa pjesë kodrinore, janë prekur nga vërshimet edhe disa nga kulturat bujqësore janë dëmtuar.

Po inspektohen të gjitha zonat të cilët janë dëmtuar nga breshëri si dhe nga vërshimet të cilët janë shkaktuar nga reshjet e fundit të shiut. Në fund të këtij procesi Drejtoria e Bujqësisë do të del me një raport përfundimtar për të gjitha dëmet e shkaktuara në bujqësi. Pasi të përpunohen të dhënat e grumbulluara do të hartohet raportë i detajuar për dëmet që u janë shkaktuar fermerëve të komunës sonë dhe i njëjti do të dërgohet në Qeverinë e Kosovës dhe Ministrinë e Bujqësisë, me të cilën shpresojmë që edhe këtë vit Qeveria jonë të ndajë mjete për dëmshpërblimin e fermerëve të komunës së Rahovecit.



Kryetari Smajl Latifi ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me UN-Habitatin, përkatësisht Gwendoline Mennetrier, kryekëshilltare teknike për bashkëpunim në planifikimin hapësinor. Kjo marrëveshje i hap rrugë procesit për ideimin e konkursit për Sheshin Qendror të Qytetit. Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit së bashku me UN-Habitatin është në fazën finale të planit për mbajtjen e konkursit ndërkombëtar për projektimin e sheshit.

Punët te Objekti për Banim Kolektiv në Rahovec, janë afër përfundimit. Drejtoria e Urbanizmit, duke parë nevojën që të renovohet ky objekt ku banojnë shumë qytetarë e zhvillojnë aktivitet biznesor disa njësi sipërmarrëse, ka kontraktuar një kompani përmes procedurave publike, e cilaka bërë termoizolimimin dhe fasadimin e objektit. Poashtu, është duke u rinovuar edhe çatia e vjetruar e objektit, e cila vazhdimisht u ka shkaktuar probleme banorëve të kateve më të larta.



Pamje të projektit "Shtegu i Ecjes" mbi qytetin e Rahovecit. Projekt rekreativ për ecje deri te Maja e Shkodranit me gjatësi 1.5 kilometra që po finalizohet tashme nga Komuna e Rahovecit dhe mbështetur nga Ministria e Zhvillimit Rajonal.

<https://kk.rks-gov.net/rahovec>



Në prezantimin e raportit "Indeksi i konkurrueshmërisë së komunave" ku janë paraqitur gjetjet e anketës me 3350 biznese nga 38 komunat e Kosovës, gjetje këto përmes së cilave është arritur deri te vlerësimi i qeverisjes lokale në bazë të ambientit përkrahës për zhvillim të bizneseve. Komuna e Rahovecit është renditur në vendin e dytë në nivel të 38 komunave të Kosovës.



Rregullimi i parkut në fshatin Gexhe, investim i komunës së Rahovecit në kuader të projektit për krijimin e hapësirave të blerta.



Pamje - Rruga Transite në Rahovec.



Banorët e Opterushës edhe me një projekt të ri kapital!

Duke e parë nevojën imediate për mbrojtjen e burimit të fshatit (Ujit të pijshëm) kryetari i komunës z.Smajl Latifi, ka autorizuar Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit që së bashku me kompaninë për hartimin e projekteve, të bëjë detyrat projektuese të projektit detal të përroskës së vendbanimit Opterushë.



Vazhdon projekti i mirëmbajtjes, në:
Rreth-rrotullimet në hyrje dhe dalje të qytetit, pastrimin e varrezave të dëshmorëve dhe civilëve me radhë sipas prioriteteve!



Po vazhdon projekti i mirëmbajtjes së hapësirave publike, ku në të njejtën kohë, kompanitë e kontraktuara nga komuna e Rahovecit, po kujdesen edhe për;
Mbledhjen e mbeturinave përgjatë segmenteve rrugore, mirëmbajtjen rrugore në të dy anët e rrugës, duke bërë pastrimin e barishteve përgjatë rrugëve!

Ka përfunduar muri mbrojtës në rrugën "Asllan Kleqka"!

Një projekt i tillë është realizuar për shkak të rrezikut permanent që ka qenë muri i mëparshëm, ishte rrezik për shkak të shembjes, por tashmë është kaluar ky rrezik! Siguria e qytetarëve, në rend të parë!



Dy probleme janë zgjidhur përmes intervenimeve emergjente!
Trajtimi dhe rehabilitimi i gropës së krijuar mbi urën e Rimnikut, rruga në drejtim të Drenocit, heqja e deponisë inerte, në mes vendbanimëve Opterushë dhe Zoqisht, përgjatë rrugës rajonale Rahovec - Suharekë!



Jemi në përfundim të punimeve të sinjalizimit rrugor horizontal të rrugës, Rahovec, Drenoc, Senoc, Pastasel, Polluzhë - deri në Sarosh.

Vazhdimisht jemi duke punuar në drejtim të përmirësimit të kushteve të sigurisë rrugore!



Jemi fitues të 40 kontejnerëve të rinjë dhe shportave për mbeturina, ku prej 13 komunave fituese, komuna e Rahovecit fiton grandin më të madh të kontejnerëve.

Falënderojmë të gjithë vullnetarët, nxënësit, dhe aktivistë ambientalistë, që u bashkuan me ne në kuadër të fushatës “Ta Pastrojmë Kosovën”.



Në fshatin Dobidol filluam me pastrimin e kanalit përgjatë rrugës, do të fillohet me hapjen e rrugës në drejtim të varrezave katolike. Këtu do të bëhet një hapësirë e lirë para shkollës fillore, krijimi i një hapësire për parking, si dhe do të bëhet një incizim i ri për rrjetin e ri të kanalizimit.

Ka përfunduar asfaltimi i rrugëve në qytet, të cilat kanë qenë të demoluara!



Me këto pamje të rregullimit të rrugës në drejtim të vendi i rënies së dëshmorit Ersan Mazrek, në mes të fshatrave Reti dhe Reti e Ulët, projekt ky i realizuar bashërisht në mes komunës së Rahovecit dhe Mamushës



Këto janë pamjet e pastrimit të mbeturinave përreth lumit Drin, përreth varrezave dhe në fshat. Janë larguar 3 deponi ilegale:

1. Deponia tek lumi Drin,
2. Deponia te varrezat e fshatit,
3. Deponia tek një lagje në brendësi të fshatit Çifllak!



Edhe një projekt i përfunduar, një zotim i kryer nga kryetari i komunës z. Smajl Latifi, në përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Ndërtimi i rrugës kryesore në brendësi të fshatit Polluzhë!



Investime në infrastrukturë çdo ditë e më tepër janë prioritet që ka vënë në plan komuna e Rahovecit. Në foto të paraqitura janë punimet në ndërtimin e trotuarit në brendi të fshatit Sopniq, përgjatë segmentit kryesor të rrugës! Mbrojtja dhe siguria e qytetarëve në rend të parë



Pas angazhimit të madh në çdo lokalitet, duke falenderuar punëtorët e KRM Ekoregjionit në Rahovec, kemi bërë eliminimin e deponisë së mbeturinave në mes të fshatrave Retijë dhe Retijë e Ulët!



Është përmbyllur me sukses faza e ndërtimit të dy segmenteve rrugore në fshatin Pastasel.



Është finalizuar traseja e re rrugës "Tafil Zyberaj" në Rahovec.



Në foto janë paraqitur punimet në ndërtimin e trotuarëve në fshatin Malësi e Vogël. Duke e ditur se në këtë pjesë të aksit rrugor rajonal, ka pasur vazhdimisht aksidente dhe vështirësi në qarkullimin e këmbësorëve, DSHP-ja ka investuar në ndërtimin e trotuarit në këtë pjesë të rrugës.



Vazhdon projekti i mirëmbajtjes së hapësirave publike, lapidarëve, vend rëniet e dëshmorëve, varrezave civile, brezave rrugor, etj. Kompanitë e kontraktuara nga komuna e Rahovecit, vazhdojnë mirëmbajtjen, sipas planit të paraparë nga DSHP.



Pas shumë shqetësimeve të banorëve të Vrajakës me probleme me ujëra të zeza, DSHP-ja rekomanduan që këtij problemi të madh të ujërave fekale, t'i bëhet zgjidhja e duhur dhe e menjëhershme.

Përmes intervenime emergjente janë bërë ndërhyrje në këtë lokalitet, në tre segmente të rrjetit të ujërave fekale.





Ka filluar zgjerimi i ndriçimit publik në rrugët e lagjeve në fshatin Xërxë



Pas reshjeve të shumta në komunën e Rahovecit, jemi kujdesur në mirëmbajtjen rrugore dhe hapjen e disa kanaleve për trajtimin e ujërave atmosferik. Përmes intervenimeve emergjente, si komunë jemi duke u kujdesur në pastrimin e rrugëve, si;

- ✓ Rruga "Gëzim Hamza-Piktori" në Rahovec,
- ✓ Rruga Rahovec-Drenoc,
- ✓ Hapja e kanalit në Fshatin Potoqan i Poshtëm etj.



Është bërë shenjëzimi i rrugëve në qytet!



Edhe një punë e mirë në përmirësimin e kushteve edukative arsimore dhe infrastrukturën moderne të objektit të ri shkollor në ndërtim në fshatin Hoçë e Vogël

NE VAZHDOJMË ME REALIZIMIN E PREMTIMEVE!



Pamje - Infrastruktura rrugore në Zoqisht!

Deponitë ilegale të mbeturinave po eliminohen, në tërë territorin e komunës së Rahovecit!

Po vazhdon projekti i pastrimit në hapësira publike.



Po përfundohen punë edhe te kroi afër Sahat Kullës në Rahovec. Deri më tani është bërë vendosja e gypit të ri të ujit si dhe funksionalizimi, pastaj vendosja e ulësës, montimi i qeshmeve, thyerja, pastrimi, gërryerje e murit ekzistues në sipërfaqet e brendshme, drunj dekorativ, mbushja e sipërfaqes së mureve me material të nevojshëm, si dhe do të vendoset pllaka për emërimin e kroit me mbishkrime.

Po vazhdojnë punimet në kuadër të projektit për restaurim të trashëgimisë kulturore. Janë përfunduar shumica e punëve të planifikuara në kroin, rruga Sheh Ilmi Maliqi, pastaj pastrimi i terrenit nga mbeturinat të cilat dalin para dhe gjatë ekzekutimit të punimeve, punimi i ujëmbellësit prej metali, mbushja e fugave në pjesën ballore si dhe në pjesën e pllatos, veshja e pjesës ballore si dhe në sipërfaqe të kroit të murit me pllaka të gurit natyror.

Do të punohet edhe në: Vendosjen e karrigeve në këtë vend, vendosja e pllakës për emërimin e kroit.



Aktivitetet e Kryetarit të komunës së Rahovecit dhe drejtorive, gjatë periudhës korrik – dhjetor 2019

Me rastin e Ditës së Eksportit të Prodhimeve Bujqësore Kryetari i komunës së Rahovecit ishte pjesëmarrës në Qendrën për Pemë dhe Perime “Agrocelina” në Xërxë, qendër të cilën komuna e ka mbështetur vazhdimisht

Spektori i bujqësisë, si sektor kyç i zhvillimit të Rahovecit do të ketë përkrahje të vazhdueshme nga komuna e Rahovecit



Me qëllim që bashkëatdhetarët tanë të priten sa më mirë gjatë pushimeve të tyre, Kryetari i komunës ka marrë dy vendime të cilat kanë për qëllim lehtësimin e qëndrimit të tyre në Kosovë. Vendimi i parë ka të bëjë me zgjatjen e orarit të punës për zyrtarët e gjendjes civile, zyrës së pranimit dhe zyrës së tatimit në pronë, të cilët nga 15 korriku do të punojnë deri në ora 18:00 gjatë ditëve të javës dhe nga ora 09:00 deri në orën 12:00 të shtunën, kurse, me vendimin e dytë, punëtorët e komunës obligohen që të lirojnë hapësirat për parking në oborrin e komunës, për mërgimtarët.

Kryetari z.Smajl Latifi ka mbajtur debatin e parë publik me qytetarët në ambientet e Kuvendit Komunal të Rahovecit, ku është prezantuar puna e kryer për 6-mujorin e parë të vitit 2019. Përveç kësaj, janë prezantuar planet dhe projektet tona për pjesën e mbetur të vitit 2019, e më pas është diskutuar me bashkëqytetarët. Takime me qytetarë rrisin efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien tonë si qeverisje, në mënyrë që bashkë, të kontribuojmë për të mirën e Rahovecit.



Kryetari Latifi priti në takim ministren e Bujqësisë, Dijana Zhivic, me të cilën u diskutua për bujqësinë në Rahovec, si sektori kyç për komunën tonë. Ministrja u informua për ecurinë e punëve në Rahovec, fazat e aplikimit për grante dhe subvencione e poashtu i'u dorëzuan disa kërkesa që konsiderohen të rëndësishme për bujqit, konkretisht: Rritjen e subvencioneve, përkrahjen për rregullimin e rrugëve fushore si dhe rregullimin e kanaleve të kullimit



Vazhdojmë me ndërtimin e fushave sportive, të cilat aq shumë ju kanë munguar të rinjëve tanë.

Në Lagjen e Epërme, në qytet, nisi puna për një fushë tjetër sportive në komunën tonë. Derisa në Dejnë po vazhdojnë punimet, së shpejti do të ndërtojmë edhe dy fusha të tjera sportive, në Kramovik dhe Opterushë.

Për nder të 21-vjetorit të Epopesë së Rahovecit bashkë me OVL-në, bashkëlloftëtarë, familjarë të dëshmorëve, janë mbajtur aktivitete të shumta në nderim të të rënëve për lirinë që e gëzojmë sot



Kryetari i komunës së Rahovecit ka nënshkruar marrëveshje financimi për Komunën e Rahovecit me z. Fatmir Matoshi, Ministër i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Sipas kësaj marrëveshjeje, do të financohet projekti i rregullimit të shtratit të lumit nga Hoça e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac e deri në Krushë të Madhe.



Është mbajtur "Rahovec Tour", një organizim i bukur nga të rinjtë e Rahovecit, të cilët pas shëtitjes me biçikleta nëpër natyrën e bukur të Rahovecit, u ndalën për një aktivitet - ndriçimin e veçantë të qiellit të Rahovecit. Ky aktivitet, ku kishte pjesëmarrës nga e gjithë Kosova, dëshmon se Rahoveci ka rini kreative dhe natyrë të bukur e përshtatshme për ngjarje të tilla që promovojnë komunën tonë



Fotografi të realizuara rastin e 21-vjetorit të rënies dhe shpalosjes së Shtatores të Shejh Myhedin Shehu, në prej figurave që la emër në historinë më të re të lirisë dhe pavarësisë së Republikës së Kosovës



Homazhe te *MAJA E SHKODRANIT*
(21- vjetori i kujtimit të sakrificës së dëshmorëve)



Ne vazhdimisht po përkrahim fermerët dhe së fundmi kemi hapur edhe thirrje për subvencione për mekanizëm bujqësor, ku janë përfshirë të gjithë sektorët e bujqësisë.





Kryetari Latifi ka takuar punëtorët e administratës së Komunës së Rahovecit, takimet e tilla, të rregullta, janë praktikuar gjithmonë, për t'u siguruar se punët në komunë po ecin mirë dhe se qytetarët tanë arrijnë t'i kryejnë punët e tyre pa vështirësi.



I shoqëruar nga nënkryetari Fatmir Iska dhe drejtori i DSHMS-së Samir Mustafa, kryetari Latifi ka takuar punëtorët shëndetësor në hapësirat e QKMF-së në Rahovec. Praktika të tilla të komunikimit të drejtpërdrejtë me punëtorët e QKMF-së, na ndihmojnë në krijimin e stabilitetit në rrjetin e shërbimit shëndetësor parësor të komunës së Rahovecit, në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët tanë.



Në fshatin Xërxe përruam ndriçimin publik, fshat ky që tashmë ka ndriçim në shumicën e vendbanimit. Mbi 7km rrugë janë të ndriçuara vetëm në Xërxë. Ne do të vazhdojmë me projekte të ngjashme në gjithë komunën e Rahovecit.





Bujqësia është një prej sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë në Rahovec. Komuna e Rahovecit është e interesuar që këtë sektor, i cili Rahovecin e bënë edhe më të zhvilluar, edhe më të bukur, ta mbështesë edhe më shumë. Këtë vit, komuna jonë ndau 1 milion euro vetëm për bujqësi, ndërsa vitin e ardhshëm ky buxhet do të rritet.



Ka përfunduar fushata e korrje-shirjes së grurit në komunën e Rahovecit. Sipas raporteve të para, bëjnë të ditur se rendimentet e grurit janë rreth 4200 kilogram për një hektar. Korrja e 1/ha gruri me autokombanjë ka kushtuar 90-110 €

Kryetari Smajl Latifi ka inspektuar nga afër korjet-shirjet që janë zhvilluar në komunën tonë, duke pasur parasysh se kultura e grurit është një kulturë strategjike për vendin tonë, Kryetari Smajl Latifi ka uruar fermerët, për punën dhe përkushtimin e tyre për rendimentin e fituar i cili për këtë vit pothuajse është rekord.





Janë duke vazhduar punimet në projektin “Kanali i kullimit të tokave bujqësore në Xërxe”. Punimet janë duke u zhvilluar në krahun 2, segmenti Xërxe-Fortesë dhe pas hapjes së kanalit do të fillojë edhe betonimi



Ka përfunduar inspektimi i gjendjes së serrave për fermerët të cilët kanë përfituar nga komuna e Rahovecit. Komisioni i cili është formuar me vendim të Kryetarit Smajl Latifi për verifikimin e serrave, kanë mbaruar vizitat tek çdo fermer i cili është përfitues i këtyre ambienteve të mbrojtura. Nga inspektimi fizik i këtij projekti, gjendja ishte mjaft e mirë si dhe çdo ambient i mbrojtur pothuajse ishte i mbjellur me kultura të ndryshme perimore.



Vazhdon rregullimi i rrugëve fushore-vreshtare. Ministria e Bujqësisë është duke investuar në rregullimin e infrastrukturës bujqësore në territorin e komunës së Rahovecit.



Infrastruktura
rrugore
Zoqisht.



Mirëmbajtja e varrezave
të Dëshmorëve, tek vendi
i quajtur "Hamoc".
Mirëmbajtja e varrezave
civile të qytetit në
Rahovec.



Sanimi i gropave në
Opterushë





Sanimi i rrugës me
elemente betoni në rrugën
"Agim Qelaj" në Rahovec.
Ndërtimi i trotuarëve në
pjesën brenda fshatit
Sopniq.



Jemi afër përfundimit të
segmentit rrugor në fshatin
Zoqisht. Zgjidhja më e mirë e
këtij segmenti rrugor është
heqja e shtyllave të vjetra të
elektrifikimit (tensionit të
lartë), që ka qenë pengesë
kryesore e ndërtimit të kësaj
rruge



Kanë filluar punimet në rrugën "Vëllezërit Frashëri", në një teren të
vështirë të kalueshëm.
Vazhdon edhe në disa segmente tjera në Rahovec, projekti i ndërtimit të
rrugëve lokale.



Pastrimi i deponisë mbi fshatin Zoqisht.



Vazhdon mirëmbajtja e rregullt e deponisë legale të mbeturinave inerte (Demolimit).
Mirëmbajtja, rrafshimi dhe kujdesi i rregullt i deponisë.



Fasadimi dhe ngjyrosja e mureve të jashtme të objekteve shkollore të shkollës "Rudolf Walther" në Dejnë dhe paraleles së ndarë në Dobidol.





Ka përfunduar furnizimi me lëndë djegëse (dru) për ngrohje gjatë dimrit, për të gjitha shkollat e komunës sonë!

Drejtoria Komunale për Arsim ka marrë të gjitha masat që ky furnizim të bëhet pa asnjë vonesë dhe në një afat rekord në të gjitha shkollat




Fotografi të realizuara gjatë punimeve në realizimin e projektit "Drenazhimi dhe Hidroizolimi i objekteve shkollore" në Shkollën e Mesme të Lartë "12 Maji" në Ratkoc.

Bodrumet e këtij objekti shkollor nuk do të përmythen më nga uji.



Në kuadër të aktiviteteve për "Ditët e Mërgatës", Drejtoria Komunale për Arsim në bashkëpunim me Zyrën për Ndërlidhje me Mërgatën të komunës sonë organizuan një orë letrare me titull "Malli Poetik për Vendlindjen" në fshatin Dejnë.



Në kuadër të realizimit të projektit të bashkëpunimit me Bankën Botërore, shkolla fillore "Vëllezërit Frashëri" në Drenoc u furnizua me mjete didaktike dhe konkretizimi!

Me anë të këtyre pajisjeve, nxënësit do ta kenë më të lehtë të përvetësojnë njohuritë që marrin nga mësuesit e tyre!



Punimet për restaurimin e krojeve janë duke u zhvilluar në bazë të planit dinamik.
Janë duke vazhduar punimet në Nushpal, Zoqisht, dhe në Lagjen e Epërme.



Biblioteka në Krushë të Madhe ka pësuar rritje në fondin librar përgjatë këtij viti.
Rreth 236 ekzemplarë me libra i janë ndarë Bibliotekës në Krushë të Madhe gjatë kësaj periudhe kohore



Janë organizuar aktivitete sportive në Palestrën "Mizahir Isma" mes komunës së Rahovecit, dhe komunitetit jo shumicë. Ky aktivitet është inicuar nga OSBE gjatë hartimit të Planit të punës së KKS-së, dhe është përkrahur nga kryetari i komunës z. Smajl Latifi, DKRS-së dhe anëtarë të KKS-së. Është prioritet i yni, të mbrojmë identitetin etnik, kulturor, gjuhësor e fetar të pakicave kombëtare.



Në kuadër të aktiviteteve për ditët e mërgatës është mbajtur koncert festiv për mërgimtarë " Anës Drinit me Mërgatën".



Punimet në rrugën Rahovec - Hamoc – Fortesë. Kjo rrugë e prioritetit të lartë përfshin sipërfaqe të mëdha të tokave të mbjella me vreshta, lidh 1000 bujq, është e gjatë 10.1 km me infrastrukturën përcjellëse - dhe është projekt financiar prej Mi-së, e që zbatohet nga Komuna e Rahovecit



Fillimi i punimeve për ndërtimin e rrugës Xërxë – Sapniq – Ratkoc. Ky projekt shumë i rëndësishëm për banorët e kësaj ane, që financohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit e implementohet nga Komuna e Rahovecit, kap vlerën e 898,888 eurove dhe ka gjatësi 12 mijë metra, shenjzim horizontal , vertikal dhe shtegun për çiklizëm. Asfaltimi i kësaj rruge ka rëndësi të madhe për fermerët dhe bujqit e kësaj zone, ne jemi të vendosur që të zhvillojmë komunën dhe zonën rurale.



Festivali i vjeljes së rrushit “Hardh Fest” dëshmoi edhe njëherë se me punë, përkushtim e vullnet arrihet gjithçka! Qytetarët e Rahovecit dëshmuan përsëri vlera të larta mikëpritëse dhe bujarie për të gjithë turistët që vizituan Rahovecin duke përjetuar peizazhin e bukur të vreshtave, e pjesëmarrjen në aktivitetet e shumta me 16, 17 dhe 18 gusht 2019.



Po vazhdojnë punimet për ndërtimin e fushave sportive në Komunë të Rahovecit. Pas fillimit të ndërtimit në Rahovec e Dejnë, filluan ndërtimet edhe në Kramovik dhe Opterushë.



Ka filluar zyrtarisht procesi i hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit, dokumentit të planifikimit urban, me të cilin do të përcaktohen kushtet zhvillimore e ndërtimore, lloji, destinimi dhe shfrytëzimi i hapësirës në gjithë territorin e komunës.

Komuna e Rahovecit, që është bartëse e këtij projekti, së bashku me kompaninë konsulente është e përkushtuar që të hartojë Hartën Zonale në shërbim të një planifikimi të mirëfilltë urban, duke konsultuar me dëgjime publike gjithë qytetarët e interesuar, bizneset, OJQ-të dhe grupet tjera të interesit.



Në Çifllak, u bë përrurimi i fillimit të punimeve për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare! Ky projekt, që kap vlerën e 82,996 eurove është shumë i rëndësishëm për banorët e kësaj ane dhe qasjen e tyre më të lehtë në shëndetësi, si një sektor jetik për mirëqenien e qytetarëve.





Shoqata e bletarëve “Rahoveci” në bashkëpunim me komunën e Rahovecit ka mbajtur ligjëratë dhe bashkëbisedim me temën “Përgatitja e bletëve për dimërim”.

Nje organizim mbresëlënës me pjesëmarrje dhe interesim të lartë nga bletarët e komunës së Rahovecit!

Bletaria është sektor i rëndësishëm i bujqësisë së vendit, burim prodhimesh natyrale me vlerë të lartë ushqimore, dietale e mjekësore!

Komuna e Rahovecit, do ofrojë mbështetje të vazhdueshme në mënyrë që ky sektor të zhvillohet edhe më shumë.



Vendosëm gurthemelet për ndërtimin e objektit të SHFMU “Liria” në Fortesë, projekt i rëndësishëm dhe i nevojshëm për nxënësit, mësimdhënësit dhe arsimin e këtij fshati!

Duke parë gjendjen e rëndë të shkollës aktuale, ne kemi vendosur që të investojmë në ndërtimin e objektit të ri modern, që do të jetë i standardeve më të larta dhe do të përfshijë edhe sallën e edukatës fizike.



Festivali "AgroFesta", një organizim i krushjanëve që feston kultivimin dhe traditën e perimekulturës në këtë rajon. Komuna e Rahovecit sivjet ka rritur mbështetjen për këtë festival i cili tashmë është tradicional dhe i cili po i sjell Krushës e Rahovecit vizitorë nga anembanë Kosova. Kjo përkrahje dëshmon fokusimin tonë serioz për fermerin dhe bujqësinë.





Kemi formalizuar binjakëzimin e Komunës së Rahovecit me komunat arbëreshe të Frasnitës (Frascineto) dhe Çiftit (Civita).

Një akt ky shumë i rëndësishëm, që mban të forta lidhjet e arbëreshëve me prejardhjen e tyre dhe me komunat shqiptare siç është Rahoveci. Në bazë të marrëveshjes, komunat tona do të kenë bashkëpunim të thellë mes vete sidomos në aspektin e komunikimit, ekonomik, projekteve të përbashkëta e shumëçka tjetër.

Kryetari Latifi ka nënshkruar kontratën për rregullimin e rrugëve fushore në gjithë territorin e komunës së Rahovecit.

Projekti, i ndarë në 3 lote, kap vlerën e 412,445.87 eurove dhe është ndër projektet më të rëndësishme për fermerët tanë, pasi që do të rregullohen gjithsej 74 km rrugë fushore.

Nuk do të ndalemi me projekte të tilla për fermerët e Rahovecit, si: mekanizma bujqësorë, serra, stalla, ferma, pajisje, rrugë fushore etj.



Ka filluar projekti i ndërtimit të parkut në Pataqan të Ulët. Në kuadër të këtij projekti parashihet një hapësirë e madhe e gjelbëruar, me parking për vetura, kënd lojërash për fëmijë, kënd basketbolli për të rinjë dhe ulëse përgjatë rrugicave të parkut. Në kontratën që kemi lidhur, përveç këtij parku, parashihet edhe ndërtimi i shtatë parqeve të tjera, të cilat do të ndërtohen në Sapniq, Celinë, Zoqisht, Malësi e Vogël, Ratkoc, Dobidol dhe Senoc.

Më shumë mjedise të gjelbëruara - më shumë jetë!



Në vazhden e investimeve që po bën Komuna e Rahovecit, në këtë rast, në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, është edhe rruga e cila të shpie deri në "Majën e Shkodranit".

Rruga është e gjatë 2925 metra, ndërsa e gjerë 5 metra. Ky projekt është i një rëndësie të veçantë, sepse, jo vetëm lehtëson lëvizjen e automjeteve për te Kalaja e Gurit, e ndërtuar për nder të katër dëshmorëve që ranë në Epopenë e Rahovecit në korrik 1998, por nga dita në ditë, kësaj zone po i shtohet pesha dhe roli, duke tërhequr gjithnjë e më shumë vizitorë.



Me moton "Regjistrohu në klubin e zemrës tënde", Komuna e Rahovecit, përkatësisht drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës, kanë organizuar Panairin e Sportit për vitin 2019, i cili mëton të promovojë sportin, klubet dhe rezultatet e arritura nga sportistët e komunës së Rahovecit.

Fëmijët e shkollave fillore dhe të mesme patën mundësi të shohin nga afër praktikimin e sporteve, poashtu edhe të regjistrohen në klubet sportive aty ku ata dëshirojnë.

Ne vazhdojmë të përkrahim sportin dhe ftojmë të rinjtë që vazhdimisht të merren me sport, ngase është dhurata më e mirë që mund t'i bëjnë shëndetit.

Në Lagjen e Epërme të Rahovecit përruam një fushë sportive, e cila do të shërbejë si pikë argëtimi për qytetarët e kësaj lagjeje.

Në këtë fushë të bukur, të rinjtë dhe të rejat mund të zhvillojnë aktivitete sportive në futboll, basketboll dhe hendboll.

Me ndërtimin e terreneve të reja sportive, Komuna e Rahovecit synon promovimin e sportit, jetesës aktive dhe të shëndetshme, angazhimin e të rinjve me aktivitete fizik, si dhe konkurrencën e shëndetshme të garës.






Mbi qytetin e Rahovecit, tek "Epopeja e UÇK-së", ka filluar ndërtimi i shtëpisë për të moshuar për qëndrim ditor. Kjo është kërkesë e kahershme e qytetarëve të moshës së shtyer dhe komuna e Rahovecit do ti jep jetë si investitor me vlerën e kontratës: 89,979.00 euro.

Në këtë qendër parashihet të ketë një sallë kolektive për qëndrim dhe aktivitete, dhoma për të pushuar si dhe teracë.



"Majën e Shkodranit" - këtë kala prej guri, prej së cilës qyteti i Rahovecit dhe rrafshi i Anadrinisë duken si në pëllëmbë të dorës, tanimë do të mund ta vizitojmë jo vetëm ditën. Tanimë shtegu i ecjes është pajisur me ndriçim, i cili edhe më tepër ia shton bukurinë dhe do të mund ta shijojmë deri në orët e vona.



Këtë vit, Komuna e Rahovecit, e cila shquhet si ndër rajonet më të mira bujqësore ka arritur të përfitojë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural 16 projekte në sektorë dhe masa të ndryshme.

Puna e vazhdueshme dhe sistematike e Komunës së Rahovecit, përkatësisht e Drejtorisë së Bujqësisë, në përkrahje të fermerëve, me konsulencë dhe hartim të projekteve për skemën e granteve është zhvilluar për herë të parë në nivel vendi dhe falë angazhimit të DBPZHR-së dhe kompanisë për hartimin e projekteve ka rezultuar e suksesshme, nga fakti që dokumentacioni i fermerëve është kompletuar në përpikmëri dhe hartimi i projekteve është bërë pa pagesë.



Është nënshkruar kontrata për realizimin e Projektit " Rregullimi i shtretërve të lumenjve në fshatrat Hoçë e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac dhe Krushë e Madhe", projekt ky i cili është bashkëfinancim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Kontrata për realizimin e këtij projekti është e ndarë në dy lote:

LOT I - vlera e projektit kap shifrën prej 738,804.69 €.

LOT II- vlera e projektit kap shifrën prej 555,535.87€.

Vlera totale e këtij projekti është 1,294,340.50€.

Rregullimi i shtratit të përroit që i përshkon këto fshatra është projekt me elemente përcjellëse si: ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza, ndërtim të urave, ndriçim, staza për ecje dhe elemente të tjera.

Duke u bazuar në nevojën e përfshirjes sa më të madhe të vendbanimeve në rrjetin e kanalizimeve fekale është nënshkruar kontrata: "Trajtimi i kanalizimeve fekale (gropa septike)".

Projekti është bashkëfinancim mes Komunës së Rahovecit dhe MAPL – së, në vlerën e përgjithshme: 438,638.29 €.

Ky projekt përfshin 15 vendbanime të komunës sonë me gjatësi mbi 14 km, me rrjet të kanalizimit si dhe gropa septike në vendet e përcaktuara në kontratë.



Në kuadër të zotimeve tona kryesore para qytetarëve të komunës së Rahovecit që të kemi sa më shumë infrastrukturë për edukimin e hershëm, kemi vënë gurthemelin e projektit shumë të rëndësishëm: Ndërtimi i Çerdhes së Fëmijëve në Krushë të Madhe.

Ky projekt është investim i komunës së Rahovecit dhe kap vlerën: 294,290.60€.



Në Brestoc kanë filluar punimet për realizimin e projektit: "Rregullimi i shtretërve të lumenjve në fshatrat Hoçë e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac dhe Krushë e Madhe", i cili është bashkëfinancim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Kontrata për realizimin e këtij projekti që ndahet në dy lote, në LOT I kap shifrën: 738,804.69 €.

Është nënshkruar marrëveshja për hapjen e konkursit ndërkombëtar për dizajnimin e sheshit qendror të qytetit të Rahovecit. Marrëveshja është arritur mes UN-HABITAT-it, agjenci e Kombeve të Bashkuara të cilën e përfaqëson Gwendoline Mennetrier, kryekëshilltare teknike për bashkëpunim në planifikimin hapësinor dhe komunës së Rahovecit. Bartëse e këtij procesi është Drejtoria e Urbanizmit e cila është duke u përkujdesur që projekti të përcillet nga procedura tejet transparente dhe moderne, duke bashkëpunuar ngushtë me UN- HABITAT- in.



Kanë filluar punimet për ndërtimin e një parku në fshatin Dobidol, projekt ky i cili është në kuadër të projekteve që ka Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për ndërtimin e tetë parqeve në komunën e Rahovecit.



Në Nagac filluam projektin “Rregullimi i shtretërve të lumenjve nga Hoça e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac deri në Krushë të Madhe”, LOT 2, me vlerën: 555,535.87 €, i cili përfshin vendbanimet Hoçë e Vogël, Nagac dhe Krushë e Madhe.

Në Xërxë vumë gurthemelin e çerdhes, projekt ky i nevojshëm për komunitetin dhe familjarët që janë në marrëdhënie pune. Çerdhja është projekt i Komunës së Rahovecit, në vlerë: 157,306.27 €, e projektuar për 60-80 fëmijë. Do të ketë 5 dhoma të mëdha dhe 4 dhoma më të vogla me një infrastrukturë të përshtatshme për më të vegjëlit.



Është mbajtur debati publik rreth Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBS-së). Në këtë debat, të pranishmit u njoftuan me punën njëvjeçare (1) të këshillit, duke përfshirë pesë (5) mbledhje të mbajtura deri më tani e që deri në fund të vitit planifikohen të mbahen edhe dy të tilla dhe Planin e Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBS – së) për vitin 2020.





Është nënshkruar kontrata për mirëmbajtjen dhe pastrimin e palestrës, e cila ishte mëse e domosdoshme për një funksionim sa më të mirë. Mirëmbajtja dhe pastrimi do të jenë sistematike, ku përfshihen të gjitha pjesët dhe elementet e palestrës, i gjithë objekti brenda dhe jashtë, si dhe mjedisi përreth saj.



Punimet në rrugën "Vëllezërit Frashëri", në një teren të vështirë të kalueshëm, vazhdon edhe në disa segmente tjera në Rahovec, projekti i ndërtimit të rrugëve lokale.



Debllokimi i ujërave fekale, që vazhdimisht shkakton telashe në kundërmim afër Xhamisë së fshatit Zatriq.



106, 233.00€ i ka fituar komuna e Rahovecit në kuadër të "Grantit të Performancës – Mjedisi i Pastër" që ndahet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me organizata të tjera, për aktivitetet e saj në pastrimin e ambientit. Komuna e Rahovecit është fituese në mesin e 20 komunave nga e gjithë Kosova.



Mirëmbajtja e rrugëve fushore në fshatin Opterushë!

Ndërtimi i trotuarëve në brezin rrugor të rrugës rajonale Xërxë-Kramovik, respektivisht në zonën e banuar të fshatit Çifllak.





Kanë filluar punimet në rrjetin e kanalizimit në fshatin Kramovik , punimet do të zhvillohen në katër lokacione.

Kompania KRU Gjakova ka filluar të bëjë shtrirjen e gypit për ujë të pijshëm për banorët e Babocit. Ky projekt është bashkëfinancim në mes komunës së Rahovecit dhe KRU Gjakovës.



Vazhdon inspektimi i punimeve në kanalin kullues në fshatin Xërxë.

Kanali kullues i cili është duke u ndërtuar në fshatin Xërxë të komunës së Rahovecit, pothuajse është në përfundim të punës finale. Ky kanal do të shpëtojë shumë hektarë të tokave bujqësore nga përmytjet e mundshme, si shkak i reshjeve të tepërta nga kushtet atmosferike.



IADK-ja në bashkëpunim me komunën e Rahovecit vazhdon përkrahjen për të riatdhesuarit me mekanizëm bujqësor. Organizata IADK në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit me komunën e Rahovecit, përkatësisht Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, kanë mbështetur 6 përfitues me mekanizëm bujqësor për fermerët e riatdhesuar të komunës së Rahovecit.

Po vazhdojnë punimet në hapësirat e Tregut të Rrushit. Tani punimet janë duke u zhvilluar me shtruarjen e kubëzave të cilët do të bëhen vendi më i përshtatshëm për shitjen e prodhimeve bujqësore që do të ekspozohen nga fermerët e vendit tonë.



Ka përfunduar faza e parë dhe e dytë e shpërndarjes së mekanizmeve bujqësore për fermerët e Komunës së Rahovecit, nga 3,100 fermer aktiv sa ka komuna jonë në këtë fazë kanë përfituar rreth 800 prej tyre. Në thirrjen që kemi hapur gjithsej aplikues ishin 844 që do të thotë kanë përfituar rreth 94% e atyre që kanë aplikuar.




Po zhvillohen punimet në rregullimin e rrugëve fushore. Rregullimi, pastrimi, shtruarja me zhavor dhe hapja e rrugëve të reja fushore janë prioritet i këtij projekti, i cili luan rol të rëndësishëm në infrastrukturën bujqësore. Punimet janë duke u zhvilluar në 3 lote të cilat operojnë dy kompani kontraktuese. Deri më tani janë rregulluar 6 rrugë në tërë komunën e Rahovecit dhe në vazhden e këtyre punimeve do të rregullohen edhe shumë rrugë tjera.

Ka filluar pyllëzimi i pronave pyjore në komunën e Rahovecit. Komuna e Rahovecit ka filluar mbjelljen apo pyllëzimin e pronave pyjore. Këtë vit parashihen të mbillen mbi 20 ha me pyje.



Ruajtja e tokave bujqësore është jetike për bujqit e komunës sonë! Punimet në projektin : “Kullimi i tokave bujqësore në Malësi të Vogël”, i nisur në vitin 2013 tanimë janë duke vazhduar. Aktualisht po punohet në krahun 1, i cili është drejttë fundit, për të vazhduar me segmentet tjera.



Kemi përfunduar projektin për riparimin e tregut në Rahovec, projekti është investim i komunës së Rahovecit me vlerë prej: 3,444 Euro, në të cilin përfshihen: Rrethimi i tregut, ngjyrosja e shtandeve, pastrimi i mjedisit, pastrimi, zhblllokimi dhe riparimi i nyjeve sanitare dhe largimi i mbeturinave përreth.



Kemi vënë gurthemelin e shkollës fillore “ Milaim Krasniqi ” në Kaznik. Projekti është investim i komunës së Rahovecit që kap vlerën: 79,857.07 Euro.

Do të jetë një shkollë me të gjitha standardet evropiane dhe një shtyllë e fortë për një arsimim cilësor të fëmijëve të këtij vendbanimi.



Komuna e Rahovecit deri më datën 30.11.2019 ka arritur të shënoj një rritje rekord të të hyrave të rregullta: 1,010,161.19 Euro. Ky vit njihet si viti më i mirë i mbledhjes së të hyrave nga komuna e Rahovecit që prej pasluftës. Kjo falë përkushtimit maksimal të qeverisë komunale, të gjithë drejtorëve dhe stafit të drejtorisë së financave, në krye me drejtorin Afrim Limani, si dhe falë vetëdijësimit dhe përkushtimit të qytetarëve për kryerjen e obligimeve ndaj komunës.



Për të parë nga afër mbarëvajtjen e procesit arsimor, sidomos në shkollat e mesme të larta, Kryetari Smajl Latifi së bashku me drejtorin e arsimit takuan mësimdhënësit e SHML "Xhelal Hajda - Toni" në qytet dhe SHML "Ukshin Hoti" në Krushë të Madhe. Nga këto dy takime Kryetari kërkoi nga organet drejtuese të shkollave dhe nga mësimdhënësit ngritjen e nivelit të përgjegjësisë, evitim të papërgjegjësisë eventuale dhe ngritjen e përkushtimit për të ngritur në një nivel më të lartë cilësinë në arsim. Ne jemi të përkushtuar që sistemit arsimor në komunën tonë t'i kushtojmë vëmendje edhe më të madhe sepse është prioritet i yni arsimimi dhe edukimi i gjeneratave të reja.

Në ditëlindjen e atdhetarit dhe shkrimtarit tonë të madh, Sulejman Krasniqi, shënuam Ditën e Bibliotekës Komonale e cila me nder mban emrin e tij. Kuvendi i Komunës së Rahovecit, më 30 prill 2019, me propozimin e Kryetarit të komunës, ka miratuar ndarjen e çmimit "Sulejman Krasniqi" për krijimtari letrare, të cilin e kemi ndarë për herë të parë, dhe po ashtu ndamë Mirënjohje për të gjithë ata dhurues të librave që pasuruan fondin e Bibliotekës sonë.



Kemi mbajtur takimin e tretë për vitin 2019 me punëtorët shëndetësor të QKMF-së në Rahovec. Diskutuam për procesin e mbarëvajtjes së punës dhe për investimet që po bëhen aty, numrin e mjekëve që janë shtuar dhe për nevojat që ka shëndetësia në komunën tonë. Të përkushtuar që të kemi një sistem shëndetësor sa më efikas si një shtyllë bazë në mirëqenien e gjithë shoqërisë.



Në fshatin Pataqan të Poshtëm po vazhdojnë punimet e ndërtimit të njërit nga 8 parqet e planifikuara të ndërtohen në komunën e Rahovecit. Punimet do të vazhdojnë edhe në pjesën brenda parkut, me stazat për ecje, ulëse, hapësira për aktivitete sportive dhe kënd lojrash për fëmijë.



Pamje nga realizimi i projektit Shtegu i ecjes në fshatin Dejnë.

Ka vazhduar shpërndarja e fazës së tretë e mekanizmave bujqësorë për fermerët e komunës së Rahovecit. Nga ky kontingjent janë shpërndarë: 124 koshere për bletë për 27 fermerë bletarë, 19 freza, 9 plugje dhe 1 automizer. Shpërndarja e radhës do të vazhdojë në bazë të furnizimeve të cilat do të ofrojnë kompanitë kontraktuese





Kjo hapësirë në Malësi të Vogël të Rahovecit po shëndrrohet në park për banorët e këtij fshati. Këtë vit po bëhet kubëzimi dhe pushimoret e planifikuara në projekt, ndërsa në pranverë të vitit të ardhshëm do të bëhet gjelbërimi dhe mbjellja e drunjve.



Filluam ndërtimin e parkut në fshatin Sopniq, ky është parku i katërt i filluar këtë vit, ndërsa në pjesën e parë të vitit tjetër do të fillojnë të ndërtohen edhe katër parqe të tjera në kuadër të kontratës që ka komuna e Rahovecit për hapësirat e gjelbëruara!

Rregullimi i varrezave të dëshmorëve në fshatin Dejnë.





Rregullimi i rrugëve fushore në fshatin Zatriq.
Kjo rrugë ka rëndësi të veçantë pasi që i lidh dy komuna, Malishevën dhe Klinën. Ta gëzojnë banorët e kësaj ane.

Kanë nisur punimet në rregullimin e oborrit të 'Shtëpisë së Fshatit' në Senoc. Investim i komunës së Rahovecit.



Po vazhdojnë punimet në kanalin kullues në Ratkoc , Malësi dhe Gexhë. Aktualisht po punohet në krahun 1 i cili është në përfundim në drejtim të Drinit të Bardhë. Ky kanal po ndërtohet sipas kushteve më të mira të cilat do të shpëtojnë shumë toka bujqësore nga vërshimet dhe fatkeqësitë e ndryshme natyrore.



Në fshatin Baboc, pas një kërkesë të kamotshme është funksionalizuar uji i pijshëm, i cili ishte mëse i nevojshëm për popullatën e këtij vendbanimi. Ne si komunë e Rahovecit, respektivisht angazhimit maksimal të Kryetarit Smajl Latifit në bashkëpunim me zyrtarë të KRU "Gjakovës", kemi arritur ta përfundojmë projektin e furnizimit me ujë të këtij fshati.

Filluam me krijimin e parkingjeve të reja në qytet rreth Palestrës Sportive "Mizahir Isma".

Komuna e Rahovecit, respektivisht Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në kuadër të programit për zhvillimin e bujqësisë për vitin 2019, për herë të parë ka filluar ndërtimin e stallave dhe fermave të vogla për fermerë. Kapaciteti i stallës është deri në 8 krerë, ku në të përfshihen infrastruktura dhe gropat septike.





Po vazhdon dekorimi i qytetit të Rahovecit për festat e fund vitit.



Shtëpia e Kulturës “Mensur Zyberaj” u furnizua me pajisje me zërim, dhe pajisje tjera të nevojshme, gjë që ndikon në rritjen e efikasitetit të punës. Tashmë, kemi një pjesë të mjeteve për realizim sa më efikas të programeve kulturore e edukative



Është nënshkruar kontrata për projektin më të madh që njih historia e pasluftës në komunën e Rahovecit: Rruga katër (4) korsi Rahovec- Xërxe. Projekti është i komunës së Rahovecit, përkatësisht Drejtorisë së Shërbimeve Publike si bartëse e tij, i përkrahur financiarisht nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit. Vlera totale e projektit është: 6,513,953.60 € dhe është i ndarë në tri Lote.

PËRFUNDIM

Duke u mbështetur në synimet tona, kemi vënë prioritetet tona qeverisëse në funksion të zhvillimit të gjithmbarshëm të komunës sonë, në këtë dokument janë të paraqitura të gjitha aktivitetet më kryesore gjatë vitit 2019 si dhe ecuria e realizimit të projekteve kapitale.


Në bazë të nenit 68, paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, në bazë të neneve 23, 24 dhe 25 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, nenit 7 pika 1 të Rregullores Komunale për Transparencë, Kryetari i komunës së Rahovecit, organizon DEBAT PUBLIK me qytetarët e komunës së Rahovecit.

Duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, komuna e Rahovecit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin e vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Të nderuar qytetarë,

Ndihma juaj dhe zëri juaj do të jetë gjithnjë udhërrëfyes për ne, vetëm të bashkuar dhe me përkrahjen e të gjithëve mund të arrijmë tek synimi i të gjithë neve për ta bërë Rahovecin komunë në të cilin e vlen për të jetuar dhe për t'u vizituar. Rruga drejt këtij synimi është e vështirë, por unë dhe ekipi im jemi të përkushtuar që të punojmë sa më shumë dhe sa më mirë për të arritur këtë qëllim.

Rahovec
Dhjetor 2019



Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit

